

VENDIM
Nr.643, datë 21.12.1999

**PËR HEQJEN E EMBARGOS SË NAFTËS DHE TË NËNPRODUKTEVE TË SAJ PËR
REPUBLIKËN E MALIT TË ZI DHE KOSOVËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", ne propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore kompetente mund të autorizojnë shitjen, furnizimin apo eksportin direkt ose indirekt të naftës dhe të nënprodukteve të saj nga çdo person juridik apo fizikë në territorin e Republikës së Malit të Zi dhe Kosovës, nëse respektohen kushtet e mëposhtme:

-nafta dhe nënproduktet e saj që shiten, furnizohen apo eksportohen të mos tranzitohen nga territori i epublikës së Serbisë, dhe

-nafta dhe nënproduktet e saj të mos dalin nga territori i Republikës së Malit të Zi dhe Kosovës për asnjë destinacion tjetër në territorin e Republikës së Serbisë.

2.Autorizimet për kryerjen e veprimeve të mësipërme të bëhen në bazë të rregullores nr.2111/1999, datë 4.11.1999 të Këshillit të Ministrave të BE-së.

3.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.233, datë 22.5.1999, shfuqizohet.

4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera kompetente, për nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta